



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura VI
Sesioni pranveror

Seanca plenare e Kuvendit
SP-025
Prishtinë, më 30 mars 2018, në orën 15:30

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS,
E MBAJTUR MË 30 MARS 2018**

Seancën e kryesoi Kadri Veseli, kryetar i Kuvendit, i ndihmuar nga Xhavit Haliti, nënkryetar i Kuvendit.

Kryetari i hapi punimet e seancës plenare, sipas rendit të ditës, të caktuar me vendim të Kuvendit nr. 06-V-087, në seancën e mbajtur më 23 mars 2018.

1. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Sami Kurteshi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe mbikëqyrjen e Agjencisë kundër Korrupsionit, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 37 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 28, 29, 30, 31, 32, 33, 34, 35, 36 dhe 37.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet 25, 26 dhe 27.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 54,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 19.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-011 për parandalimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

2. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034 dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Albulena Haxhiu, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Legjislacion, Mandate, Imunitete, Rregulloren e Kuvendit dhe Mbikëqyrjen e Agjencisë Kundër Korrupsionit, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit, diskutimi i të cilës është i dhënë në transkript.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 6 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi i miratoi këto amendamente: amendamentin nr. 1 (propozimin e deputetit Korab Sejdiu), amendamentin nr. 2 (propozimin e deputetit Korab Sejdiu), amendamentet me numër 3, 4 dhe 5 (propozimin e Komisionit FunkSIONAL) dhe amendamentin me nr. 6 (të riformuluar sipas propozuesit, deputetes Albulena Haxhiu).

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 1.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-025 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-225 për Prokurorin e Shtetit, i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 05/L-034.

3. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kontrollin e brendshëm të financave publike dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Driton Selmanaj, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Mbikëqyrjen e Financave Publike, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 15 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14 dhe 15.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 62,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-021 për kontrollin e brendshëm të financave publike.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-026 për azil

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për azil dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 31 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22, 23, 24, 25, 26, 27, 28, 29, 30 dhe 31.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-026 për azil.

5. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Fatmir Xhelili, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 11 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10 dhe 11.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 57,
Kundër ----- 2,
Abstenime ----- 2.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-036 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-219 për të huajt.

6. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Deputeti Driton Çausi, në emër të Komisionit FunkSIONAL për Bujqësi, Pylltari, Zhvillim Rural, Mjedis e Planifikim Hapësinor, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 23 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 5, 6, 7, 9, 12, 13, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Kuvendi nuk i miratoi amendamentet: 4, 8, 10, 11 dhe 14.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-029 për mbrojtjen nga rrezatimi dhe sigurinë bërthamore.

7. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Lumir Abdixhiku, kryetar i Komisionit FunkSIONAL për Buxhet dhe Financa, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 23 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18, 19, 20, 21, 22 dhe 23.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-032 për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim.

8. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-037 për metrologji

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për metrologji dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin të propozuara gjithsej 19 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13, 14, 15, 16, 17, 18 dhe 19.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-037 për metrologji.

9. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit Funkcional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e paraqiti dhe e arsyeoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin propozuara gjithsej 14 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, amendamenti nr. 9 (i riformuluar sipas propozimit të deputetes Sala Berisha-Shala, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 63,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-041 për kërkesat teknike për produkte dhe vlerësim të konformitetit.

10. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për pajisjet nën presion dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin propozuara gjithsej 14 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 65,
Kundër ----- 0,
Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-031 për pajisjet nën presion.

11. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës

Kryetari i njoftoi deputetët se komisionet parlamentare e kanë shqyrtuar Projektligjin për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës dhe Kuvendit ia kanë rekomanduar miratimin e tij me amendamentet e propozuara.

Sala Berisha-Shala, kryetare e Komisionit FunkSIONAL për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti, Industri dhe Zhvillim Rajonal, e paraqiti dhe e arsyetoi raportin e komisionit.

Në këtë projektligj ishin propozuara gjithsej 14 amendamente.

Kryetari i hodhi në votim amendamentet e propozuara.

Kuvendi me shumicë votash i miratoi këto amendamente: 1, 2, 3, 4, 5, 6, 7, 8, 9, 10, 11, 12, 13 dhe 14.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim tekstin e projektligjit me amendamentet e miratuara.

Rezultati i votimit ishte, si në vijim:

Për ----- 64,

Kundër ----- 0,

Abstenime ----- 0.

Kuvendi me shumicë votash mori këtë:

V E N D I M

Miratohet Ligji nr. 06/L-039 për Shërbimin Gjeologjik të Kosovës.

* * *

Në fund të seancës, kryetari i Kuvendit e shtroi çështjen e mospranisë së deputetëve në punimet e seancave plenare. Ai propozoi që deputetëve që nuk janë të pranishëm në seancë t'u hiqen mëditjet. Ai kërkoi deklarin kryetarëve të grupeve parlamentare në lidhje me propozimin e tij.

Lidhur me propozimin e lartcekur të kryetarit diskutuan: Bilall Sherifi, në emër të GP të Nisma; Arben Gashi, në emër të GP të LDK-së; Glauk Konjufca, në emër të GP të LVV-së; Ahmet Isufi, në emër të GP të AAK-së; Memli Krasniqi, në emër të GP të PDK-së dhe Dardan Sejdiu, në emër të GP "Deputetët e Pavarur", diskutimet e të cilëve janë dhënë në transkript.

Pastaj, kryetari e hodhi në votim propozimin e lartshënuar, por nuk pati kuorum të mjaftueshëm për vendimmarrje.

Kryetari i mbylli punimet e seancës plenare në orën 18:45 minuta.

Kryetari i Kuvendit:
Kadri VESELI

Procesverbalin e hartoi:

Drejtorja për Çështje Plenare dhe Procedurale